



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 7, datë 30. 03. 2009

PËR

**“RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE NIVELIN E PAGAVE
TË DISA NDËRMARRJEVE NË VARËSI TË BASHKISË SË TIRANËS,
PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN E SPORTISTËVE TË NIVELIT TË
LARTË, SI DHE MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, shkronja “c”, kreut IV, nenit 19, nenit 32, shkronja “ç” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; pikës 17 të vendimit të KM-së nr. 1619, datë 02.07.2008 për “Klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”; vendimit të KM-së nr. 502, datë 16.04.2008 për “Administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” (i ndryshuar); vendimit të KM-së nr.1720, datë 29.10.2008 për “Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”; vendimit të KB-së nr.1, datë 03.02.2009 për “Miratimin në parim të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2009-2011 dhe miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2009” dhe sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë riorganizimin dhe disa ndryshime në strukturat e:

- a. Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit sipas organigramës bashkëlidhur.
- b. Drejtorisë nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, në Drejtori të Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit sipas organigramës bashkëlidhur.
- c. Drejtorisë nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit sipas organigramës bashkëlidhur.
- d. Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHEF) sipas organigramës bashkëlidhur.

2. Të miratojë nivelin e pagave të punonjësve të:
 - a. Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit, sipas **lidhjes nr. 2** bashkëlidhur këtij vendimi.
 - b. Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, sipas **lidhjes nr. 3** bashkëlidhur këtij vendimi.
 - c. Drejtorisë Nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit sipas **lidhjes nr. 4**, bashkëlidhur këtij vendimi.
 - d. Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHFE) sipas **lidhjes nr. 5**, bashkëlidhur këtij vendimi.
 - e. Qendrës kulturore "Tirana", sipas **lidhjes nr. 6** bashkëlidhur këtij vendimi.
 - f. Klubit sportiv "Tirana", sipas **lidhjes nr. 7/1** bashkëlidhur këtij vendimi.
 - g. klubit të futbollit "Tirana", sipas **lidhjes nr. 7/2** bashkëlidhur këtij vendimi.
 - h. Ndërmarrjes së Shërbimit Funeral, sipas **lidhjes nr. 10** bashkëlidhur këtij vendimi.
 - i. Njesisë së Menaxhimit të Projekteve, sipas **lidhjes nr. 12** bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë për punonjësit e Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, ndryshimin e nivelit të **pagës së grupit** (diplomë e shkollës së lartë) nga **10 050 në 11 000 lekë**.
4. Për zbatimin e pikave 1/a dhe 1/b të këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, ngarkohen të kryejnë inventarët dhe veprimet e nevojshme kontabël e financiare, si dhe çdo veprim tjetër juridik të detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi.
5. Kalimi i funksionit të administrimit të konvikteve të sistemin arsimor parauniversitar pranë Bashkisë së Tiranës.
6. Efektet financiare të këtyre ndryshimeve do të fillojnë 01.04.2009 dhe do të mbulohen nga fondet e miratuara për paga, sigurime dhe shpenzime operative për këto institucione.
7. Të miratojë një shtesë në buxhetin e vitit 2009 (artikulli Shpenzime operative) për mbulimin e trajtimit ushqimor të sportistëve të nivelit të lartë duke shtuar respektivisht buxhetet e Klubit Sportiv Tirana në shumën prej 15,000,000 Leke si dhe Klubit të Futbollit Tirana në shumën prej 2,000,000 leke. Efektet financiare të kësaj shtese do të përballohen duke pakësuar fondin rezervë miratuar me buxhetin e vitit 2009 për Bashkinë e Tiranës në shumën 17,000,000 Leke.
8. Të miratojë një shtesë në buxhetin e vitit 2009 (artikulli Paga 1,500,000 Leke dhe sigurime 300,000 Leke) për efekt të pikës 3 (vetëm për Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore) duke pakësuar për shumën 1,800,000 fondin rezervë.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi revokohen:
 - a. Vendimi i KB nr.18, datë 30.07.2004, për "Miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit" (*i ndryshuar*)
 - b. Vendimi i KB nr.13, datë 10.03.2004, për "Miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të Drejtorisë nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit" (*i ndryshuar*)

- c. Vendimi i KB nr.15, datë 10.03.2004, për "Strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Drejtorisë nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit" (*i ndryshuar*)
 - d. Vendimi i KB nr.8, datë 21.03.2005, për "Disa ndryshime në strukturën organizative të Drejtorisë nr.2 të Punëtorëve të Qytetit, Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve si dhe nivelin e pagave të Ndërmarrjes së Përpunimit të Plehut" (*i ndryshuar*)
 - e. Vendimi i KB nr.63, datë 06.12.2007, për "Disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të vartësisë"
 - f. Vendimi i KB nr.11, datë 11.04.2008, për "Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Njesisë së Menaxhimit të Projekteve (PIU)"
10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHEF), qendra kulturore "Tirana", klubi sportiv "Tirana", klubi i futbollit "Tirana", Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale, Njësia e Menaxhimit të Projekteve, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.
11. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R

Dixhitalizuar nga Qendra për Qeshjtjet e Informacionit Publik, QIP
www.informacion.org
www.vendime.al

Lidhja nr. 2

Niveli i pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit

Nr.	Funksioni	Klasa	Paga bazë	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për vështirësi në %
			1	2	3
1	Drejtor i përgjithshëm	XIV	70 000	1%	
2	Zv. drejtor i përgjithshëm	XIII	60 000	1%	
3	Drejtor drejtorie	XII	56 000	1%	
4	Drejtor njësie	XI	50 000	1%	
5	Përgjegjës sektori teknik (trajtimi mbetjeve urbane)	X	38 000	1%	5%
6	Përgjegjës sektori teknik	X	38 000	1%	
7	Përgjegjës i sektorit të menaxhimit të fushës	IX	35 000	1%	5%
8	Përgjegjës sektori	IX	35 000	1%	
9	Specialist I	VIII	31 000	1%	10%
10	Specialist II	VII	28 000	1%	
11	Manovrues	VI	25 000	1%	15%
12	Teknik të mesëm (topograf-preventivues, t/implanteve ujitëse, t/task-forcë, arkëtar, furnitor, sekretar, protokollist)	VI	25 000	1%	
13	Shofer mjeti teknologjik, trajtim mbetjeve	V	23 000	1%	15%
14	Shofer mjeti teknologjik, punëtor fushe, mekanik i trajtimit të mbetjeve	V	23 000	1%	10%
15	Punëtor transporti, punëtor heqje plehrash, task-forcë, mekanik-xhenerik	V	23 000	1%	
16	Shofer mjeti mbi 2,5t	IV	22 000	1%	
17	Punëtor shërbimi për kafshët	III	21 000	1%	10%
18	Punëtor gjelbërimi, pastrimi	III	21 000	1%	

19	Shofer, magazinier	II	20 000	1%	
20	Roje fushe	I	18 000	1%	10%
21	Punëtor magazine, pastrues	I	18 000	1%	

Shtesa për vjetërsi në punë për lidhjen nr. 2 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

Lidhja nr. 3

Niveli i pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit

Nr.	Funksioni	Klasa	Paga bazë	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për vështirësi në %
			1	2	3
1	Drejtor i përgjithshëm	XIV	70 000	1%	
2	Drejtor drejtorie	XII	56 000	1%	
3	Përgjegjës sektori	X	38 000	1%	
4	Përgjegjës i sektorit të ndriçimit	IX	35 000	1%	5%
5	Përgjegjës zyre	IX	35 000	1%	5%
6	Specialist	VIII	31 000	1%	
7	Specialist ndriçimi	VIII	31 000	1%	5%
8	Teknik të mesëm ndriçimi, manovrues	VI	25 000	1%	10%
9	Teknik të mesëm (topograf, teknik zbatues, dispeçer, ofiçina, mirëmbajtës makinash, arkëtar, furnitor, sekretar, protokollist)	VI	25 000	1%	
10	Punëtor gatishmërie për ndriçimin	VI	25 000	1%	5%
11	Shofer mjetesh teknologjike	V	23 000	1%	
12	Punëtor prodhimi, pllakash, brumi, asfalti, frantoje	V	23 000	1%	10%
13	Shofer mjete mbi 2,5t	IV	22 000	1%	
14	Punëtor asfalti, punëtor zgarash	III	21 000	1%	10%

15	Punëtor pllakash	III	21 000	1%	
16	Shofer, magazinier	II	20 000	1%	
17	Punëtor magazine, pastrues	I	18 000	1%	

Shtesa për vjetërsi në punë për **lidhjen nr.2 të jepet në masën 1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet** dhe të llogaritet mbi **pagën bazë**.

Lidhja nr. 4

Niveli i pagave për punonjësit e Drejtorisë Nr .3 të Punëtorëve të Qytetit

Nr.	Funksioni	Klasa	Paga bazë	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për vështirësi në %
			1	2	3
1	Drejtor	XII	56 000	1%	
2	Përgjegjës sektori	X	38 000	1%	
3	Përgjegjës zyre	IX	35 000	1%	
4	Specialist	VIII	31 000	1%	
5	Teknik të mesëm, inventarizues, preventives, arkëtar, furnitor, sekretar, protokollist	VI	25 000	1%	
6	Shofer mjete teknologjik	V	23 000	1%	5%
7	Shofer mjete mbi 2,5 t	IV	22 000	1%	
8	Punëtor mirëmbajtje (hidraulik, elektrikist, kaldaist, çbllokues, marangoz, murator, bojaxhi), punët. vendstrehimi, DDD	III	21 000	1%	10%
9	Shofer, magazinier	II	20 000	1%	
10	Punëtor ngarkim-shkarkimi, pastrues	I	18 000	1%	

Shtesa për vjetërsi në punë për **lidhjen nr. 4 të jepet në masën 1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet** dhe të llogaritet mbi **pagën bazë**.

Lidhja nr.5

Niveli i pagave për punonjësit e Qendrës Ekonomike së Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

Nr.	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
			1	2	3	4
1	Drejtor i përgjithshëm	III-a	1	2%	64 000	7000
2	Drejtor	III-b	1	2%	47 000	5000
3	Përgjegjës sektori	III-b/1	1	2%	30 000	3000
4	Përgjegjës zyre	IV-a	1	2%	27 000	1000
5	Specialist	IV-a	1	2%	27 000	
6	Përgjegjës çerdheje	IV-b	1/2	2%	22 000	1000
7	Specialist i mesëm	IV-c	2	2%	20 000	
8	Kujdestare, kuzhinierë	IV-c/1	1/2	2%	17 000	1000
9	Arkivist-sekretar, magazinier	IV-c/2	2	2%	15 000	
10	Kujdestare, kuzhinierë me kualifikime të ndryshme profesionale				25 000	
11	Nd. kuzhinierë ,sanitare, shofer, mirëmbajtës				24 000	
12	Punëtor magazine, pastrues, roje				23 000	

Shtesa për vjetërsi në punë për lidhjen nr. 5 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

Paga e grupit është si në tabelë:

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	Diplomë e shkollës së lartë	11 000
2	Diplomë e shkollës së mesme	7 000
3	Diplomë e shkollës 8-vjeçare	3 500

Lidhja nr. 6**Niveli i pagave për punonjësit e qendrës kulturore “Tirana”**

Nr.	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushtet e punës
			1	2	3	4
1	Drejtor	III-a	1	2%	60 000	
2	Zv. drejtor	III-b	1	2%	37 000	
3	Përgj. sektori, udhëheqës artistik	III-b/1	1	2%	31 000	
4	Dirigjent, regjisor, koreograf, aktor, specialist	IV-a	1/2	2%	28 000	
5	Akrobat I, mjeshtër profili, mësues studio	IV-a/1	1/2	2%	27 000	3000
6	Akrobat II	IV-b	1/2	2%	23 000	2000
7	Orkestrant, formulues muzike	IV-b/1	1/2	2%	22 000	1000
8	Elektricitist, mekanik	IV-c	2	2%	19 000	1000
9	Llogaritar-arkëtar, magazinier, sekr.- prot, gardier, shofer, kinooperator, këpucar, rrobaqepës	IV-c/1	1/2	2%	18 000	
10	Akrobat III, inspektor skene				30 000	
11	Punëtor skene				27 000	
12	Pastruese, rrobalarës, roje				24 000	

Shtesa për vjetërsi në punë për lidhjen nr. 6 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

Paga e grupit është si në tabelë:

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	Diplomë e shkollës së lartë	11 000
2	Diplomë e shkollës së mesme	7 000
3	Diplomë e shkollës 8-vjeçare	3 500

Lidhja nr. 7/1**Niveli i pagave për punonjësit e klubit sportiv "Tirana"**

Nr.	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
			1	2	3	4
1	Drejtor klubi	III-b	1	2%	45 000	
2	Trajner	IV-a	1	2%	35 000	
3	Përgjegjës i zyrës së financës	IV-b	1	2%	25 000	
4	Llogaritar-arkëtar, masazhist	IV-b/1	1/2	2%	22 000	
5	Përgjegjës terrenesh	IV-b/1	2	2%	22 000	
6	Shofer				29 000	
7	Punëtor terrenesh				24 000	

Shtesa për vjetërsi në punë për lidhjen nr. 7/1 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

Paga e grupit është si në tabelë:

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	Diplomë e shkollës së lartë	11 000
2	Diplomë e shkollës së mesme	7 000
3	Diplomë e shkollës 8-vjeçare	3 500

Lidhja nr. 7/2**Niveli i pagave për punonjësit e klubit të futbollit "Tirana"**

Nr.	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
			1	2	3	4
1	Drejtor klubi	III-b	1	2%	45 000	
2	Trajner	IV-a	1	2%	35 000	
3	Përgjegjës i zyrës së financës, inspektor futbollit	IV-b	1/2	2%	25 000	
4	Përgjegjës terrenesh	IV-b/1	2	2%	22 000	
5	Magaznier	IV-c	2	2%	21 000	
6	Shofer				29 000	
7	Punëtor terrenesh, roje				24 000	

Shtesa për vjetërsi në punë për lidhjen nr. 7/2 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

Paga e grupit është si në tabelë:

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	Diplomë e shkollës së lartë	11 000
2	Diplomë e shkollës së mesme	7 000
3	Diplomë e shkollës 8-vjeçare	3 500

Lidhja nr. 10**Niveli i pagave për punonjësit e Ndërmarrjes së Shërbimit Funeral**

Nr.	Funksioni	Klasa	Paga bazë	Shtesa për vjetërsi
			1	2
1	Punëtor fushe	II	20000	1%
2	Roje objektsh	I	18000	1%

Shtesa për vjetërsi në punë për lidhjen nr. 10 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

Lidhja nr. 12

Niveli i pagave për punonjësit e Njesisë së Menaxhimit të Projekteve (PIU)

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
1	Drejtor i projektit	II-a	11 000	2%	103 500
2	Specialist	III-b	11 000	2%	51 500
3	Shofer				28 000

Shtesa për vjetërsi në punë **jepet në masën 2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet** dhe llogaritet mbi **pagën e grupit**.

Dixhitalizuar nga Qendra për Qeshjtjet e Informimit Publik, ÇIP
www.infocip.org
www.vendime.al